

The background is a vibrant landscape featuring a lush green valley with rolling hills and dense vegetation. In the distance, a range of blue mountains rises against a clear sky. A brown, textured paper tag is positioned diagonally across the middle of the image. The tag has a circular hole on its right side, through which a white string is threaded and loops around. The text on the tag is written in a white, handwritten-style font.

Udhërrëfyes
Parku Natyror
Rajonal Shkrel



Cooperazione Italiana
Ministero degli Affari Esteri
Ministero della Cooperazione Internazionale



Udhërrëfyes Parku Natyror Rajonal SHKREL

Informacion • Hotele • Bujtina • Restorante • Guida • Harta



Publikuar nga

Deutsche Gesellschaft für
Internationale Zusammenarbeit (GIZ)
GmbH

Zyrat Qëndrore: Bonn dhe
Eschborn, Gjermani

VIS - Vullnetarizmi Ndërkombëtar
për Zhvillimin
(Volontariato Internazionale
per lo Sviluppo)
Zyrat Qendrore: Romë, Itali

Ky botim është përgatitur në kuadrin e projekteve:

Ruajtja e Agrobiodiversitetit në Zonat
Rurale të Shqipërisë
Conservation of Agrobiodiversity in
Rural Albania (CABRA)

“Bukë, Kripë e Zemër - Ushqimi,
Tradita dhe Kultura: procese të
bashkëzhvillimit në zonat e
margjinalizuara të veriut dhe
jugut të Shqipërisë”

Adresa:

Rr. Skenderbej, P. 6, Ap. 4,
Tirana, Albania
www.giz.de

Rr. Don Bosko c/o
Qendra Sociale Don Bosko
Pall. Grapshi, 1/4/1
Tiranë, Albania
www.

Dizajn:

One Designs

*Fotografite e përdorura për këtë botim janë e drejtë e autorit: GIZ & VIS.
GIZ & VIS janë përgjegjës për përmbajtjen e këtij publikimi.*

Në emër të:

Ministritë Gjermane të Ekonomisë
dhe të Zhvillimit (BMZ)
Bundesministerium für
Wirtschaftliche Zusammenarbeit
und Entwicklung (BMZ)

Ministritë italiane të Punëve
të Jashtme (MAE)
Ministero italiano degli Affari
Esteri (MAE)

LUGINA e PARKUT NATYROR RAJONAL SHKREL

Parku Natyror Rajonal (PNR) Shkrel që është krijuar së fundmi, ka një sipërfaqe të përgjithshme prej 20,282 ha. Parku gjendet rreth 10 km në veri-lindje të qytetit Koplik, dhe kufizohet nga:

- Veriu: Kelmendin dhe me Parkun e Alpeve - kategoria e II e IUCN (Parku i Alpeve perfaqëson një Park që është në proces krijimi dhe pritet të përfundojë brenda vitit 2015).
- Lindja: Pulti dhe Parku Kombëtar Theth
- Jugu: Gruemira dhe Kopliku
- Perëndimi: Kastratin dhe pjesërisht me Koplikun

Shkrel, një bukuri e rrallë e Alpeve Shqiptare, 20 km larg nga Shkodra. Një vend për t'u vizituar në çdo stinë. Gjatë verës do të mund të shijoni ajrin e pastër dhe të freskët të Razmës në 1000 m lartësi ose mund të bëni shëtitje të gjata nën hijen e pemëve të gështenjave të Reçit, Lohes dhe Qafë Gradës. Të apasionuarit pas shëtitjeve në natyrë do të zbulojnë shtigjet e shumta që përshkojnë peisazhin alpin të Bogës. Në një natyrë të paprekur dhe të shoqëruar nga udhërrëfyes vendas mund të vizitohen në kthesat gjarpëruese të kanionit të Përroit të Thatë dhe në shpellat e shumta që gjenden në zonë brenda të cilave ka shumë histori dhe legjenda.

Qëndrimi në bujtina dhe hotele, ushqimi natyral, rizbulimi i traditave të lashta do ta bëjnë udhëtimin tuaj në Shkrel të paharrueshëm. PNR Shkrel gjendet në zemër të Alpeve Shqiptare dhe është cilësuar si "Porta hyrëse e Alpeve". Ai ndodhet ndërmjet "Parkut Kombëtar të Thethit" dhe "Liqenit të Shkodrës". Afërisa me këto dy parqe e bën atë një destinacion të rëndësishëm. Avantazh tjetër është dhe afërsia me Malin e Zi, vetëm 25 km larg.

PNR Shkrel dhe plani i menaxhimit të tij është hartuar në vitin 2014, me mbështetjen e projektit "Ruajtja e agrobiodiversitetit në Shqipërinë rurale (CABRA), i financuar nga GIZ.



Si arrihet në Parku Natyror Rajonal (PNR) Shkrel?

Me makinë private: Në Parkun Natyror Rajonal Shkrel arrihet lehtësisht me makinë private. Të gjithë fshatrat kryesisht arrihen me makina të zakonshme. Pra nuk është e nevojshme që makina të jetë e lartë përveç zonave shumë të thella.

Me autobus: Ka autobus si dhe minibus të cilët nisen çdo ditë, kryesisht çdo orë nga Shkodra për në Koplik. Më pas është e nevojshme që të merren minibuse nga Kopliku për në PNR Shkrel. Minibuset nisen nga qendra e Kopikut, tek kryqëzimi që te çon për në Shkrel, çdo 1 orë.

Me aeroplan: Nga Aeroporti “Nënë Tereza” me anë të një taksie mund të transferoheni direkt në Shkodër. Një tjetër mundësi është të merrni autobusin e vënë në dispozicion nga kompania “Tirana Express” i cili niset çdo orë nga aeroporti për në Tiranë. Nga Tirana mund të rezervoni një autobus ose minibus për në Shkodër, e më pas të merrni një minibus tjetër për në Koplik. Nga Kopliku ju duhen vetëm 15 minuta për të arritur në Shkrel.

Me anije: PNR Shkrel mund të arrihet edhe me anije nga ura e Bunës, përmes Liqenit të Shkodrës. Ka kompani lokale të licensuara që ofrojnë këtë shërbim. Kontakt: +355672060337.



Agrobiodiversiteti në PNR Shkrel

Për shkak të afërsisë me Alpet, kjo zonë shquhet për një larmi të madhe gjenesh, speciesth, ekosistemesh dhe peizazhesh, apo përmbledhur me një fjalë, për biodiversitetin. Njerëzit që jetojnë atje kanë ruajtur praktika tradicionale të kujdesjes ndaj biodiversitetit ndër shekuj, duke mbrojtur kështu bimësinë lokale dhe gjënë e gjallë, të cilat sigurojnë jetesën e tyre.

Atyre që u pëlqen të ngjiten mund të marrin një ide të këtij ushtrimi dhe të biodiversitetit bujqësor plot ngjyra, qoftë në formën e varieteteve të ndryshme të rrushit, qershive, misrit, domateve, gështenjave, sherbelës ose lavanderit, apo edhe prodhimeve bujqësore, të tilla si vera, sallatat, reçeli dhe çajrat, ose djathi dhe produkte të tjera bulmeti nga mbarështimi vendas i dhive dhe bagëtime të tjera.



Agrobiodiversiteti në PNR Shkrel

Rritja e specieve vendase dhe kujdesja ndaj kafshëve unike në këtë rajon ndihmon në lehtësimin e ndikimeve negative të bujqësisë mbi biodiversitetin dhe ruajtjen dhe mbrojtjen e ekosistemeve lokale. Kjo është e rëndësishme për të ruajtur cilësinë e tokës, ajrit dhe ujit, të cilat, nga ana e tyre, i lejojnë speciet e rralla të bimësisë së egër dhe kafshëve të mbijetojnë dhe të lulëzojnë në zonat e mbrojtura të Alpeve të Shqipërisë. Ruajtja e biodiversitetit në PNR Shkrel shkon paralelisht me zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe social: fermerët mund të konkurrojnë në treg duke u ofruar një larmi varietetesh konsumatorëve. Ata mund t'ua shesin produktet e tyre malore vizitorëve të ndryshëm dhe dyqaneve në rajon. Kjo, nga ana tjetër, shërben për të tërhequr vizitorët që dëshirojnë të mësojnë më shumë për origjinën e produkteve të caktuara dhe mënyrën sesi përpunohen ato.



Biodiversiteti në PNR Shkrel

Fauna endemike dhe specie të rrezikuara: si salamandra, tritoni, gabonja, shqipja e vogël, vjedulla, dhia e egër, etj.

Lloje bimësh endemike: Wulfenia baldacci, Campanula Albanica, Hellebours multifidus, Lilium Albanica, të cilat përbëjnë 10% të specieve endemike të Shqipërisë. Parku është i pasur me një mori lulesh të ndryshme, të cilat i kalojnë mbi 60 lloje.

Bimë aromatike-mjekësore: sherbela, kamomili, çaji i malit, trumzë, lavandula, sanza, trëndafili i egër, lule blini, dëllinja e zezë dhe dëllinja e kuqe, thundërmushka e shumë të tjera.

Habitate: PNR Shkrel karakterizohet nga një diversitet i lartë i habitateve dhe ekosistemeve si pasojë e pozicionit gjeografik dhe ndikimit të faktorëve ekologjikë në këtë zonë, duke konsideruar që ka një shtrirje gjeografike shumë të gjerë, nga 300 deri në 2400 m/mnd.

- Pyje me shkozë të zezë
- Pyje termofilë të ahut
- Pyje malore dhe sub-alpine të ahut
- Pyje me dushqe dhe shkozë
- Habitate të përrenjve dhe lumenjve
- Pyje të përziera të maleve Dinarike (Pishe e zezë, Ah, Dushqe, etj)
- Kullotat termofile
- Habitate shkëmbore të zonës së temperuar

Bime autoktone/vendase me vlera kombëtare -Parku Natyror Rajonal Shkrel

Gështenja – ky frut identifikues për Reçin - janë veçanërisht të njohura në këtë zonë për shijen e tyre të ëmbël dhe natyrale. Kjo gështenjë ka mbi 300 vite dhe përbën një trashëgimi pasurore jo vetëm për Reçin por për tërë Malësinë e Madhe. Nisur nga rëndësia e saj, me vendim qeverie në vitin 1974 Gështenja e Reçit është shpallur monument natyror.

Sherbela (*salviae folium/salvia officinalis L.*) është një bimë shumëvjeçare, autoktone e zonës, e gjendur kudo në pjesët shkëmbore, në zonën e shkurreve në Shkrel. Bima gjendet si e kultivuar ashtu edhe spontane dhe lulëzon nga muaji maj-korrik. Sherbela gjen një përdorim shumë të madh në industrinë e farmaceutikës, industrinë ushqimore, kozmetikë dhe ka përdorim shumë të gjerë si çaj.

Brrushi rrezaki (llaznë). Lloj mjaft interesant, i zonës së Shkrelit, me shtrirje interesante në Reç. Është lloj me vile të ngjeshur, të rëndë e mjaft prodhues. Kokrra është vezake, tipikë e rrushit për tavolinë, që është kompakt dhe kërcet në gojë. Prodhimin më të madh e jep nëse kultivohet si erekë, kryesisht e mbajtur në bimë të fuqishme si fojleta/kaliboba (*ceraca*), por që shkon mirë edhe në frashër e bimë të tjera.



Turizmi në PNR Shkrel

Fshatrat kryesorë për zhvillimin e turizmit janë:

RAZMA: Razma shtrihet mbi një pllajë karstike 900 – 950 m mbi nivelin e detit, e cila paraqet kontraste befasuese në reliev, mes majave piramidale në pjesën më të madhe të pyllëzuara dhe gropave karstike, të mbuluara nga kullotat alpine, me klimë shumë të mirë dhe kurative. Relievi malor me pyjet mbresëlënëse të ahut e pishës, që marrin ngjyra të ndryshme në stinë të ndryshme, e bëjnë këtë zonë shumë piktoreske. Larmia e kafshëve dhe e shpendëve të egër përbën një mundësi të mirë për të apasionuarit pas gjuetisë. Këtu mund të bëni ecje malore, piknik në lëndinat me lule, të luani në këndet e lojrave, të eksploroni shpella dhe të bëni ski.

BOGA : Boga është një fshat i vendosur në një luginë 950 m mbi nivelin e detit, i rrethuar nga Alpet. Lugina e këtij fshati fillon me Përroin e thatë në Grykë të Lugjeve dhe përfundon në Qafë T'thore në lartësinë 1700 m. Në trojet e Bogës janë gjetur dëshmi arkeologjike të vendbanimeve të hershme ilire të shek. II-III. Boga është vendi ideal për amatorët dhe profesionistët e speleologjisë. Përmen- dim këtu Shpellën e Puçit, Shpellën e Cilikokajve, Pusin e Gjek Markut, më i thelli i eksploruar në Shqipëri ku gjendet akulli fosil, Shpella e Njerëzve të Lagur, etj. Bukuria, pasuritë natyrore dhe kulturore dhe aktivitete të tjera në natyrë të këtij fshati u lënë mbresa çdo vizitori.



Turizmi në PNR Shkrel

REÇI: Reçi është një fshat i vogël dhe ka potencial kryesisht për zhvillimin e agroturizmit. Rruga që të çon drejt tij është mes fushave të mbjella me bimë heterovajore dhe në sfond ngrihen kodrat e pas tyre malet e larta. Fshati Reç është shumë i njohur pyllin e dendur me gështenja, i cili shtrihet në një sipërfaqe prej 450 ha dhe me rreth 30.000 rrënjë. Trungjet e gjera të gështenjave dëshmojnë që ato janë aty prej 3 shekujsh.

Shëtitjet në ajrin e pastër, vizita në baxjo djathi, në shpella, në fermat me dhi race autoktone dhe brenda fshtreve nën hijen e gështenjave janë një kurë e mirë antistresi.

Në shtator, kur gështenjat janë gati, këtu mund të shijoni gështenjat e pjekura, mjaltin e gështenjës si dhe ëmbëlsira të bëra me gështenja. Fshati Reç përveç pyllit të gështenjave është i njohur dhe në sajë të një ngjarje historike që daton në vitin 1943.





Llojet e turizmit në PNR SHKREL

Alpinizmi: Vendet më të përshtatshme për alpinizëm janë: Maja e Madhe 2011.4 m, Maja e Rrasave të Dedes 2117m, Maja e Kamshollit 2016 m, Maja e Mardomit 2179.9 m, Maja e Trashanit 2054 m, Raba e Ducajve 221.4 m, Maja e Rabes, 2250 m, Maja e Thatë 2541 m, Radohima 2313 m, Maja e Livadhit 2493 m, Drugomires 1904 m, Maja e Veleçikut 1725 m, etj.

Shpellat: Ekzistojnë disa shpella në zonë, të cilat janë ende të pa eksploruara. Vizita në shpella rekomandohet të bëhet me udhërrëfyes lokalë.

Hipizmi: është mënyra më e mirë për të vizituar zonën. Vendet më të përshtatshme janë akset; Dedaj-Vrith-Razem, Razëm-Bogë, Dedaj-Ducaj-Bogë, Dedaj-Reç-Repisht.

Aeronautika: Vendet më të përshtatshme janë mbi fshatin Bogë, në drejtim të Malit të Veleçikut.

Agroturizmi: Punimi dhe mirmbajtja e tokës, kultivimi i saj, vjelja dhe perpunimi i produkteve, blegtoria dhe perpunimi i prodhimeve blegtorale është ajo çka ofrohet në fshatrat e Shkrelit. Fermat zbatojnë praktika të mira në fushën e bujqësisë dhe blegtorisë, mundësisht bujqësinë dhe prodhimet organike (Bio). Reçi është mishërimi perfekt i këtij lloji turizmi.

Kampingjet:

Turizmi kulturor: Zona është e pasur në rite, tradita e zakone nga me uniket në vend. Ekspozimi i veshjeve tradicionale, pjesmarrja në festat lokale, vizita në familjet që prodhojnë apo punojnë me veshjet tradicionale, dasmat, janë një mundësi e mirë për të përjetuar këtë lloj turizmi.



Mikpritja & Gastronomia në PNR SHKREL

Tradicionalisht banorët e Alpeve janë shquar për virtytet e tyre e një nga cilësitë më të mira që ata kanë është mikpritja. Të rrethuar nga mikpritja dhe buzëqeshjet e banorëve të zonës, historitë e së kaluarës e të sotmes, këngët nën tingujt e lahutës dhe çiftelisë, gatishmëria për të ndarë me miqtë e tyre vizitorë traditat dhe kulturën e luginës së tyre do ju bëjë të ndiheni si në shtëpinë tuaj.

Kësaj mikpritjeje të pashoqe dhe panoramës mahnitëse që karakterizon zonën i shtohet edhe natyraliteti dhe gatimet e shijshme të pjatave tradicionale të pasuruara nga shijet e forta dhe unike të djathit të prodhuar në stane dhe i mishit të bagëtive që marrin më të mirën nga natyra dhe livadhet e zonës. Pjatat tipike të zonës janë: kaçimaku, ferliku, petulla me mjalhtë, bukë misri dhe djathi i zier. Trofta e Sheut të Rrjollit është karakteristike e zonës më lindore të luginës.





Disa pika për t'u vizituar në PNR Shkrel

Gështenja e Reçit: Shëtitjet në ajrin e pastër nën hijen e gështenjave janë një kurë e mirë qetësie (shteg i shënuar rrethor). Karakteristikë e veçantë është shpallja monument natyror e Gështenjës së Reçit me VKM. Kjo gështenjë është mbi 300 vjeçare.

Maja e Rrabës (Çardakut): Është shumë e përshtatshme për alpinizëm, 2222 m, dhe bora e rënë gjatë dimrit qëndron deri në gjysmën e periudhës së verës. Pamjet janë mjaft piktoreske.

Shpella e Pllumbave: Në Fshatin Reç, në drejtim të Qafë Gradës, gjendet Shpella e Pllumbave. Shpella ka shtrirje vertikale dhe eksplorimi i saj nuk është i vështirë. Shpella është e pasur me stalaktite, stalagmite dhe kolona me forma interesante. Shtegu që të shpie në këtë shpellë është përmes një mali shkëmbor me shkurre dëllinjash dhe bimë të tjera të egra mes të cilave dhe bimë mjekësore si sherebela.





Shtigje të shënuara brenda PNR Shkrel:

Shpella e Shtogut: Kjo shpellë gjendet 15 minuta ecje në këmbë nga rruga që të shpie në Razëm, pikërisht në Dukat. Kjo është një shpellë karakteristike për hyrjen e saj, për përbërjen gjeologjike dhe të veçantë që ka në krahasim me shpellat e tjera të kësaj zone, si dhe për kolonat dhe guvat.

Shpella e madhe në Bogë: Kjo shpellë ka formën e një salloni të madh. Është një vendbanim parahistorik me vlera historike. Këtu mendohet të kenë jetuar banorët e parë. Shpella paraqet interes edhe për arkeologët.

Kanioni i Përroit të Thatë: PNR Shkrel përshkohet nga kanioni i quajtur “Përroi i Thatë” i cili ka një gjatësi prej 33 km. Për shkak të terrenit të theksuar karstik, në pjesën më të madhe të vitit, ka rrjedhje nëntokësore. Vetëm në kohë rrebesesh të mëdha përroi mund të ketë rrjedhje mbitokësore. Në faqet shkëmbore veprimtaria e ujit ka formuar guva e zgavrime karstike me forma shumë interesante disa prej të cilave për nga madhësia mund të konsiderohen shpella. Shëtitja në këtë pjesë të kanionit mund të bëhet nga kushdo pasi nuk paraqet asnjë vështirësi.





Shtigje të shënuara në PNR Shkrel

Shtigje të shënuara brenda PNR Shkrel:

1. Razëm - Fushëzezë - Qafë e Keqe - Bogë
2. Razëm - Graben - Qafa Bilanit - Xhaj
3. Razëm - Krenazhdol - Q.Kunores - G.Vrinit
4. Dedaj - Lohe e Sipërme - Prelnikaj - Qafë-Gradë - Repisht
5. Razëm - Shpella e shtogut
6. Qafë-gradë - Repisht - Shtegu i Keq - Paru - Dodç - Qafë-Gradë
7. Ducaj - Gropa e Shtogut - Qafa e Shtogut
8. Shtegu rrethor i masivit të Gështenjës

Shtigje që lidhen me fshatra të tjerë:

9. Razëm-Qafa Veleçikut-Jugomire-Rrapsh (lidhje me Kastratin)
 10. Razëm-Pjetrovic-Bratosh (lidhje me Kastratin)
 11. Ducaj-Brushtull -Troshan-Qafa e Liqenit - Kaprrë "Syri i Kaltër" - Ndërlysaj (lidhje me Shalën)
 12. Bogë-Qafa e Bigës- Livadhet e Bogës-Qafa e Dobraçes-Nikç (lidhja me Kelmend)
 13. Bogë-Qafë e Keqe-Fushëzezë-Qafa e Kapes-Broje-Kozhnje (lidhja me Kelmend)
 14. Bogë-Gropa e Portës-Shtegu i Dhenve-Theth (lidhja me Shalën)
- 

Në Shkrel dhe pranë tij ... prodhues vendorë

SH.B.B. “REÇI PRODHIMTAR-bulmeti dhe gështenjat

Shoqëria e Bashkëpunimit Bujqësor “Reçi prodhimtar” është krijuar në vitin 2004. SH.B.B. Aktiviteti i SH.B.B.-së është i fokusuar në tre produkte kryesore:- Prodhimit të gështenjës, bimëve mjekësore - eterovajore (sherbelë dhe lavandula), grumbullimin dhe përpunimin e qumështit të zonës.

Kantina e Verës Miqësia, Koplik

Kush tha se SHQIPËRIA nuk bën VERË të mirë? Kantina përdor një ndërthurje mes tradicionales dhe teknologjisë së përparuar për të prodhuar verën dhe rakinë e rrushit. Verat prodhohen krejtësisht nga fruti i rrushit i cili pasi vjen nga vreshtaritë tona. Kantina Miqësia zotëron mbi 20 ha plantacione të saja, të vendosura në zonën e Zagores, në PNR Shkrel, e cila është një zonë me traditë të hershme në kultivimin e rrushit Kallmet.

Produktet: kallmet, kallmet reserve, chardonnay, chardonnay reserve, cabernet sauvignon, cabernet sauvignon reserve, raki rushi.

Kompania e Bimeve Medicinale Relikaj, Koplik

Kompania Relikaj ofron një gamë të gjerë të bimëve medicinale me çmime konkurruese. Mbledhur nga të egra dhe të përpunuara me teknologjinë më të fundit, bimeve medicinale tona mund të përdoret në farmaceutike, kozmetike apo industrinë e kuzhinës.

Produktet: kamomil, lavandë, sambucus nigra, salvia officinalis, trumza.

SH.B.B. “Reçi Prodhimtar”
Kontakt: Prek Gjeloshaj
Tel: +355685665945
Reç, Albania

Kantina e Verës Miqësia
Kontakt: Edi Likaj
Tel: +355 692316549
www.medaur.com
Koplik, Albania

Relikaj Ltd
Tel/fax +355 02112388
www.relikaj.net
Koplik, Albania





ZYRA E INFORMACIONIT TURISTIK – DEDAJ





Zyra e Informacionit Turistik ndodhet në qendër të fshatit Dedaj. Operatorët e zyrës turistike do t'ju ofrojnë informacionet e nevojshme mbi akomodimin, transportin, aktivitetet e ndryshme në natyrë, mbi zejtarinë, produktet tipike, traditën dhe kulturën e Shkrelit. Zyra ofron shërbimin e guidave natyrore nga profesionistë të vendit të cilët mund t'ju shoqërojnë në zbulimin e fshatrave, bjeshkëve dhe bukurive natyrore. Të gjitha këto do e bëjnë qëndrimin tuaj sa më të këndshëm dhe mbresëlënës. Harta dhe materiale informative janë të disponueshme pranë Zyrës së Informacionit Turistik.



+355 68 45 75 666



info@kelmend-shkrel.org



www.kelmend-shkrel.org



[kelmendshkrel](https://www.facebook.com/kelmendshkrel)







01

Relaks, qetësi, shije, traditë dhe bukuri natyrore. Këto janë 5 karakteristikat e këtij hoteli të ri dhe të mrekullueshëm ku ju do të keni mundësinë të jetoni ditët më të bukura të qëndrimit dhe të pushimeve tuaja.

Një staf profesional do t'ju mirëpresë me kënaqësi duke treguar mikpritjen e ngrohtë dhe duke ofruar kuzhinën tradicionale të Alpeve Shqiptare. Cilësia e lartë e shërbimit, në shkrimje me bukurinë e maleve, do t'ju bëjë të shijoni në maksimum atmosferën tradicionale të vendit.



FERDI
STERKAJ



+355
682001946



info@
kullaearte
.com



RAZEM



Gjate
gjithë
vitit



www.
kullaearte.
com







Një shtëpi antike e rikonstruktuar me një stil anglez, ku tradicionalja është harmonizuar me modernen, duke ofruar kështu një qëndrim shumë të rehatshëm dhe në të njëjtën kohë sipas traditës më të mirë shqiptare. "Boga Alpine Resort" ndodhet në një pozicion ku mund të shijoni magjinë e majave të larta që shtrihen prapa saj dhe në pjesën e përparme do të përfshihen nga pamja mahnitëse e luginës së Bogës. Të gjitha dhomat janë të pajisura me soba duke bërë të mundur që ju të mikpritni nga të zotët e shtëpisë edhe gjatë dimrit dhe duke ju dhënë kështu mundësinë të shijoni peisazhin e bardhë mahnitës.



GJON
ULAJ



+355 6737
06462 /
+447766
114465



boga.alpine
restort@
gmail.com



BOGE



Gjate
gjithe
vitit



6



15







03

Në mungese



ARDIAN
ULAJ



+355



-



BOGE



Gjate
gjithë
vitit



TOILET







04

Në qendër të fshatit Bogë ngrihet një bujtinë shumë e veçantë e cila njihet për ngjyrat e gjalla dhe tarracën e gjerë ku gjatë verës turistët dhe miqtë ndalojnë për një kafe turke të shijshme dhe përfitojnë nga dielli dhe pamja e mahnitshme e luginës. Bujtina ofron një mjedis të ngrohtë mbushur me objekte të vjetra dhe tradicionale. Aroma e çajit të malit, bimë tipike e njohur e zonës, e mbledhur direkt nga Nikolini dhe Shaqja, bëhet më e ngrohtë nëse do ta shijoni bashkë me të zotët e shtëpisë duke bërë muhabet dhe duke u shijuar ngadalë ashtu siç është tradita.



NIKOLIN
ULAJ



+355
694342208



nikolinboga
@yahoo.
com



BOGE



Gjate
gjithë
vitit



3



8







05

Në të djathtë të kroit të Bogës ndodhet një restorant i bukur dhe i madh i zbukuruar me gurë të vendosur në një mënyrë shumë të veçantë, tërheqëse dhe mahnitëse.

E veçanta e këtij restoranti është përgatitja e gatimeve tradicionale si petulla me mjalhtë, kos deleash dhe ferlik. Të gjitha produktet janë nga kopshti dhe ferma e pronarit, e njohur gjithashtu në fshat për shijen e mjaltit shumëlulesh. Bujtina ofron vend kampingu, dhoma të rehatshme dhe sigurisht një mëngjes të shijshëm me produkte tipike vendase.



ZEF
MIKAJ



+355
696631963



-



BOGE



Gjate
gjithë
vitit



TOILET



3



7







06

Në luginën e Bogës, përballë majës madhështore të Çardakut (2222 m high) ndodhet kjo bujtinë fantastike, pikënisja e përkryer nga ku mund të organizoni një ekskursion në këmbë.

Maja e Çardakut është shumë e famshme për numrin e shpellave të saj, të cilat janë shumë interesante për t'u vizituar. E veçanta e tyre është se edhe gjatë verës mund të gjeni dëborë në to, që në të kaluarën është përdorur nga barinjët për të ruajtur qumështin dhe mishin, apo për të pirë qumësht dhe borë gjatë ditës.

Pas lodhjes së ngjytjes në mal, mos humbisni mundësinë të pushoni dhe të shijoni ushqimet vendase në këtë vend karakteristik.



UJK
LESHAJ



+355
673782067



-



BOGE



Gjate
gjithë
vitit



TOILET



3



10







07

Restoranti i vogël dhe mbreslënës ka marrë emrin nga një pemë shumë e madhe, e cila për shekuj me radhë i dha emrin këtij vendi specifik në fshatin e Bogës. Paja është shumë e njohur për drurin e saj, i cili është shumë i thjeshtë për t'u gdhendur.

Ushqimi i ofruar në këtë restorant pasqyron bukurinë dhe elegancën e kësaj peme, meqenëse Marinte, kuzhinierja është e famshme për recetat tradicionale që ajo përgatit me mjeshtri të madhe si: byrek me bimë mali, shurup thane, kek, patëllxhanë të mbushur dhe bakllava.

**"Paja" është fjalë në dialekt për pemën e panjës*



NIKOLL
ULAJ



+355
673036190



-



BOGA



Gjate
gjithë
vitit







08

Në mungese



GJELOSH
GEGAJ



+355



-



BOGA



Gjate
gjithe
vitit





ULAJ

- **Bar Kafe**
- **Restorant**
- **Kamping**





09

Në mungese



LUIGJ
GEGAJ



+355







-



BOGA



Gjate
gjithe
vitit





Bar / Kafe
Restorant / Kamping
"PJETER ULAJ"

10

Kompleksi i Shërbimeve Pjetër Ulaj, tashmë me një experiencë në fushën e turizmit, ofron shërbim të garantuar.

Karakteristike është kuzhina tradicionale e ofruar nga Hana, e cila është kualifikuar në kuzhine.

Kuzhinën tradicionale të ndërthurur me atë moderne e gjeni në çdo kohë në kompleksin tonë.



PJETER
ULAJ



+355
692517304



-



BOGE



Gjate
gjithë
vitit



2



5





11

Në qendër të fshatit Xhaj, gjendet një restorant i vogël por me bujari të madhe. Me një eksperiencë shumëvjeçare, Bar-Restorant dhe Kamping “Mark Dragani” ka mikpritur vizitorë nga vende të ndryshme të botës. Kuzhina e ofruar është tradicionale e zonës, ku darkat në natyrë të hapur shoqërohen nga mishi në hell.



MARK
DRAGANI



+355
673128637



-



XHAJ



Gjate
gjithë
vitit



TOILET





12

Në rrugë-kalimin Dedaj-Bogë, majtas në qendër të fshatit Xhaj, gjendet Bar-Kafe-Minimarket-Karburant në sherbim 24 orë non-stop.

Siguria dhe cilësia e shërbimit janë çelësi i një udhëtimi të sigurtë. Ne jemi në gatishmërinë tuaj!



ÇESK
LAKAJ



+355
672801312







XHAJ



Gjate
gjithë
vitit



TOILET





13

Në qendër të Shkrelit, pikërisht në fshatin Dedaj, ndodhet Bar-Restorant KAPLLAJ.

Me një staf të kualifikuar, me eksperiencë shumë vjeçare Bar-Restorant KAPLLAJ ju ofron shërbim 24 orë. Salla e madhe ofron mundësinë e organizimit të eventeve të ndryshme, mbledhje, seminare etj.



PAL
KAPLLAJ



+355
673215513



-



DEDAJ



Gjate
gjithë
vitit



Udhërrëfyesit malor në Shkrel

Udhërrëfyesit malor vendas të cilët e njohin shumë mirë zonën, atraksionet turistike si dhe historitë dhe legjendat janë të përgatitur dhe çertifikuar falë kursit të formimit profesional të njohur nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, në bashkëpunim me Klubin Alpin Italian (CAI), mbështetur me financimin e Cooperazione Italiana.



DANJEL OLAJ



+355 673088180



KANTO LESHAJ



+355 673829333




RAIMOND GEGAJ



+355 674227728




Mjaftueshem



ANTON KUQAJ



+355 674823818



ARBEN MAKLAJ



+355 673824007



ARDIT MAKLAJ



+355 674334580




ARDIAN ULAJ



+355 682932671



🇬🇧 🇮🇹 🇦🇱 Mjaftueshem



TOMAS MIHAČ



+355 694894834



NIKOLIN ULAÇ



+355 694342208



PARLIND GOCAÇ



+355 682760297



@ parlind-g@hotmail.com



pak anglisht, pak italisht



PJERIN GOCAÇ



+355 673388646



@ pjerinocaj@live.com



Mjaftueshem



Mos merr
asgjë
veç foto

Mos lër
asgjë
veç gjurmë këmbësh



Mos vrit
asgjë
veç kohën

Të dashur miq!

Për një ecje të sigurtë dhe të rehatshme nevojitet informacion për shtegun e zgjedhur.

Ju lutem

planifikoni qëndrimin në natyrë me kujdes:

Informo familjen, miqtë dhe pritësin ose pronarin lokal për detajet e qëndrimit tuaj në fshat.

Përpara se të niseni, kontrolloni gjithmonë parashikimin aktual të motit.

Kontrolloni vazhdimisht kushtet e motit gjatë qëndrimit në natyrë sidomos kur të përdorni shtigjet e ngjitjes në mal dhe ecjes me biçikletë.

Kërkojini pronarit informacion shtesë për kushtet e motit lokal, si dhe rreziqet e veçanta.

Vlerësoni formën tuaj fizike dhe zgjidhni një shteg të përshtatshëm me vështirësi mesatare.

Filloni herët në mëngjes dhe planifikoni pak kohë për relaksim, shëtitje dhe kthim të sigurtë.

Gjithmonë kthehuni me ditë!

Filloni ngadalë. Zgjidhni një shpejtësi ecjeje të mirë dhe të moderuar. Pushoni pushim mjaftueshëm, veçanërisht nëse ka fëmijë në grup.

Merni me vete mjaft lëngje!

Rekomandohet të merni ujë, çaj dhe lëngje natyrale dhe ushqime me kalori si bukë gruri, fruta të thata, arra, etj.

Merni paisjet e përshtatshme për ecje në këmbë ose me biçikletë (këpucë, mbrojtëse, etj.). Merni kapele dhe diçka për të mbrojtur lëkurën nga dielli!

Merni gjithmonë telefonin celular.

Për një ecje të sigurtë dhe të rehatshme nevojitet informacion për shtegun e zgjedhur.

Zgjidhni roba të lehta dhe të ajrosura.

Mos harroni veshje mbrojtëse për shiun dhe të ftohtin. Kutia e ndihmës së shpejtë duhet të jetë pjesë e paisjeve tuaja.

Kujdesuni për pjesëtarët e dobët ose të ngadaltë të grupit dhe përshtatuni shpejtësisë së ecjes së tyre!

Tregojuni kërcënimet e mundshme personave të tjerë që takoni.

Respektoni dhe kujdesuni për natyrën.

Evitoni zhurmat e panevojshme dhe mos lini mbetje.

Ndiqui shtigjet e shënuara dhe hartat e ecjes në këmbë dhe me biçikletë.

Kur keni dyshime, kthehuni mbrapsht!

Numrat e emergjencës



Shërbimi i Urgjencës **126**



Shërbimi i Policisë së Shtetit **129**



Shërbimi i Zjarrfikësve **128**



Shërbimi i Policisë rrugore **127**